



REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

K.DH.Shk II.nr.1013/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Departamenti i Përgjithshëm, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.a, me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala” nr.4, kundër debitorit Sho Human Daneze-H.M., me adresë në rr. “Mark Isaku”, Prishtinë, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat V.H. nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1360/22 të datës 30.05.2023, me datë **14.02.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.a, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1360/22 të datës 30.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1360/22 të datës 30.05.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Sho Human Daneze-H.M., dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr. 45/21 të datës 19.01.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Fadil Hoxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,635.32 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura është përfunduar ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Sho Human Daneze-H.M. ashtu që ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.

45/21 të datës 19.01.2021, i lejuar Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha, sa i përket shumës prej 279.16 EUR.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1360/22 të datës 30.05.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm Ekstrakt nga librat e kontabilitetit me shifrën L80358, për periudhën kohore nga 01.01.2013 e deri më 14.01.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditës pas pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 2,914.48 EUR (dymijë e nëntëqind e katërbëdhjetë euro, e katër dhjetë e tetë euro cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit me arsyetimin se kërkesa që rrjedh nga dokumenti i besueshëm është përfshirë në parashkrim, kjo në kuptim të nenit 360 par.1.1.1 të LMD-së, pasi ka kaluar afati një (1) vjeçar i parashkrimit për secilën kërkesë. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe urdhri për lejimin e përmbarimit të shfuqizohet.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, për faktin se në rastin konkret debitori ka bërë pagesa të vazhdueshme në emër të konsumit të ujit për periudhën 01.01.2013 e deri më 14.01.2021, andaj përmes pagesave në fjalë, i njëjti ka pohuar borxhin në tërësi, që për pasojë sjell ndërprerjen e parashkrimit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet dhe Urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1360/22 të datës 30.05.2023, ku në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit Sho Human Daneze-H.M., dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 45/21 të datës 19.01.2021 i lejuar nga Përmbarruesi Privat Fadil Hoxha, për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,635.32 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbarrimit procedura është përfunduar ndërsa në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Sho Human Daneze-H.M. ashtu që ka mbetur në fuqi pjesa tjetër e Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 45/21 të datës 19.01.2021, i lejuar Përmbarruesi Privat Fadil Hoxha, sa i përket shumës prej 279.16 EUR.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se borxhi që rrjedh nga dokumenti Ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifrën L80358 është përfshirë pjesërisht në parashkrim, dhe atë duke iu referuar dispozitës së nenit 355 par 1 të LMD-së, sa i përket shërbimeve nga data 01.01.2013 e deri me datën 31.12.2018 në shumën prej 2,635.32 EUR borxhi është parashkruar, pasi që lidhur me borxhin që rrjedh nga këto shërbime, propozimi i kreditorit për përmbarrim është paraqitur me datë 19.01.2021, më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit të tyre për pagesë.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 435/21 të datës 05.10.2021 për borxhin në vlerë prej 279.16 EUR, pasi që Gjykata gjeti se borxhi në fjalë, i referohet periudhës kohore nga data 31.01.2019 e deri më datë 31.01.2021, e meqenëse propozimi për përmbarrim është paraqitur me datë 19.01.2021, Gjykata erdhi në përfundim se borxhi lidhur me shërbimet e ofruara për gjatë kësaj periudhë kohore nuk ka arritur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata në shkallë të parë drejtë ka vendosur sa i përket borxhit sipas faturave për periudhën kohore data 01.01.2013 e deri me datën 31.12.2018 në shumën prej 2,635.32 sepse për këtë periudhë kohore nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, e që në rastin konkret për secilën nga kërkesat sipas faturave për periudhën prej 01.01.2013 deri më datë

31.12.2018, kemi kalim të afatit të parashkrimit, për faktin se kreditori me datë 19.01.2021, ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka kërkesat e kreditorit kanë arritur afatin e parashkrimit pasi që propozimi për përmbarim është paraqitur më tepër se tri vite nga koha e maturimit të tyre për pagesë.

Ndërsa sa i përket pikës II të dispozitivit për periudhën kohore nga data 31.01.2019 deri më datë 31.01.2021, gjykata me të drejtë ka vendosur për parashkrimin e borxhit lidhur me shërbimet e ofruara sepse meç kreditori me datë 19.01.2021, ka ushtruar propozim për përmbarim, gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka arritur afati tre vjeçar.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit kur ka theksuar se nga kartela e konsumatorit shihet se debitori ka pranuar borxhin duke bërë pagesa të pjesshme mirëpo gjeti se këto pagesa janë të realizuar në emër të borxhit të përgjithshëm dhe nuk specifikojnë ndonjë faturë konkrete, dhe pretendimet e tilla i refuzoj si të pabazuara ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë, po ashtu vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: "Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve 5 komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave". Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi

të bëjmë me dokument të besueshëm siç është Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste - Kartela Financiare e Konsumatorit dhe se i njëjti është i përshtatshëm për përmbardim pasi që përmban të gjitha kërkesat nga neni 21 dhe 29 par.1 pika 2 dhe 3 të LPP -së.

Andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me gjendjen faktike rezultojnë si të pathemelta të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1013/23, me datë 14.02.2024**

**Gjyqtarja,
Saranda Bogaj-Shremeti**